

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA - SUPREME COURT OF KOSOVO

- Për: Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK)
- Nga: Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e Republikës së Kosovës (DHPGJS)
- Datë: 17 janar 2023
- Lënda: RAPORT NARRATIV PËR PUNËN E DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR PERIUdhËN 01 tetor – 31 dhjetor 2022

Në DHPGJS gjatë tremujorit të katërt kanë qenë të angazhuar 13 gjyqtarë në zgjidhjen e lëndëve, 10 prej tyre në shkallën e parë dhe 3 në shkallën e dytë gjegjësisht në Kolegjin e Apelit.


Lëndët në punë gjatë tremujorit

Gjithsej në dy shkallët gjyqësore në fillim të tremujorit të katërt të vitit janë trashëguar nga tremujori paraprak 15113 lëndë, janë pranuar edhe 156 lëndë të reja, kështu gjatë tremujorit në punë kanë qenë 15269 lëndë. Prej tyre janë zgjidhur 752 lëndë, kurse kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 14517 lëndë në dy shkallët gjyqësore.

Në shkallën e parë gjyqësore nga 14032 lëndë sa kanë qenë në punë janë zgjidhur 533 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa zgjidhura 13499 lëndë në fund të tremujorit.

Në shkallën e dytë gjyqësore nga 1237 lëndë sa kanë qenë në punë janë zgjidhur 219 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa zgjidhura 1018 lëndë në fund të tremujorit.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur gjitha lëndët e trashëguara (paraprake) në fillim të tremujorit, lëndët e reja të pranuar, lëndët në punë, lëndët e kryera dhe lëndët e mbetura të pakryera në fund të tremujorit.



Efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve në raport me lëndët e reja të pranuar gjatë tremujorit

Shkalla e efikasitetit të lëndëve të kryera në raport me lëndët e reja të pranuar gjatë tremujorit është 482.05 %, ngase janë kryer 752 lëndë ndërsa janë pranuar 156 lëndë të reja.



Krahasimi me tremujorin paraprak

Krahasuar me tremujorin paraprak (korrik - shtator) kemi rrije të numrit të lëndëve të kryera dhe të efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve në raportin lëndët e kryera dhe lëndët e reja të pranuar gjatë tremujorit.


Në tremujorin paraprak janë kryer 652 lëndë kurse shkalla e efikasitetit ka qenë 80.20% kurse në këtë tremujor (tetor - dhjetor) janë kryer 752 lëndë dhe shkalla e efikasitetit është 482.05%.

Numri i lëndëve të reja të pranuar në këtë tremujor është më i ultë se në tremujorin paraprak, në tremujorin paraprak kanë qenë të pranuar 813 lëndë të reja kurse në këtë tremujor janë pranuar 156 lëndë të reja.

Lëndët e zgjidhura sipas natyrës ligjore gjatë tremujorit


Në tabelën më poshtë, janë listuar lëndët e zgjidhura gjatë tremujorit që përfshijnë:

- 213 lëndë - AC - I, Ankesat e kundër vendimeve të Dhomës
- 6 lëndë - AC - II, Ankesat Kundër vendimeve të gjykatave tjera
- 2 lëndë - C - I, Paditë e Privatizimit
- 16 lëndë - C - II, Listat e Punëtorëve
- 45 lëndë - C – III dhe SCC Paditë Pronësore
- 470 lëndë - C – IV dhe SCL, Paditë e Likuidimit



Publikimi i vendimeve gjatë tremujorit

Gjatë tremujorit është vazhduar me publikimin e vendimeve të Gjykatës, kështu që janë publikuar në Web faqe gjithsej 516 vendime të Dhomës. Prej tyre 328 vendime janë të shkallës së parë gjyqësore kurse 188 janë të shkallës së dytë.



Regjistrimi i lëndëve të vjetra në SMIL

Gjatë këtij tremujori gjegjësisht në fund të muajit tetor është filluar edhe me regjistrimin e lëndëve të vjetra në sistemin SMIL, deri në fund të tremujorit janë regjistruar 4709 lëndë të vjetra.

Identifikimi i problemeve dhe propozimi për zgjidhjen e tyre

Problem i vazhdueshëm në DHPGJS është numri i pamjaftueshëm i stafit gjyqësor dhe atij administrativ. Duke patër parasysh numrin e madh të lëndëve dhe numrin e stafit aktual, është shumë e vështirë dhe e pa mundur të zgjidhen lëndët e grumbulluara në një afat të arsyeshëm. Kështu i propozohet KGJK-ës që të ketë në vëmendje mundësin e shtimit të numrit të stafit gjyqësor dhe atij administrativ në DHPGJS si dhe shtimin e hapësirave të punës.

Gjatë tremujorit një gjyqtarë një zyrtare administrative si dhe një përkthyes janë pensionuar kështu i propozohet KGJK-ës që të ketë në vëmendje plotësimin e pozitave të lira sa më parë që të jetë e mundur.